



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:064383

Datë: 17.02.2024

Numri i dokumentit: 05433159

P.nr.246/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Arbnijë Gashi, në lëndën penale, ndaj të akuzuarve U.T., dhe T. T., që të dy nga fshati Piranë, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje, Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.2 lidhur me par.1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prizren PP/II.nr.257-1/23, të datës 13.03.2023, në praninë e prokurorit të shtetit Labinot Jetishi, përfaqësuesit të dëmtuarës KRU Radoniqi z.B.P., të akuzuarit U.T., dhe JK. T., me datë 17.01.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa përpiloj me shkrim me datë 17.02.2024 këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.U.T., nga i ati dhe e ëma, i lindur me datë, në fshatin Piranë, Komuna e Prizrenit, i martuar, i ati i shtatë fëmijëve, ka të kryer shkollimin fillor, pensionist, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, e identifikuar me numër personal

2.T. T., nga i atidhe e ëma, i lindur me datë, në fshatin Piranë, Komuna e Prizrenit, i martuar, i ati i tre fëmijëve, ka të kryer shkollimin e mesëm, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, e identifikuar me numër personal

JANË FAJTOR

Se në periudhën kohore nga data 14 deri me datë 16 Dhjetor 2022, në fshatin Piranë, Komuna e Prizrenit, të pandehurit ne bashkëveprim me njeri tjetrin, me dashje e dëmtojnë pasurinë e të dëmtuarës - Kompania Regjionale e Ujitjes “Radoniqi – Dukagjini” Sh.a me seli në Gjakovë, në atë mënyrë që pa autorizimin e të dëmtuarës dhe me qëllim që ti largojnë gypat e vjetër të ujësjellësit, të njëjtit shkojnë në parcelën – arën e tyre dhe aty me eskavator i largojnë gypat e vjetër për ujitje duke i dëmtuar kështu rreth 120m gypa fi-200, pesë gyp të

ujësjellësit terciar, gypa polietileni, nyje lidhëse KP 200, Valvola për ndalje të ujit fi 100 - një copë, fi80-një copë duke shkatërruar kështu edhe strukturën e nivelit të shtratit të ujësjellësit, me ç’ rast me këtë veprim të dëmtuarës KRU “Radoniqi - Dukagjini” sh.a i shkaktojnë dem material ne vlerë rreth 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) Euro.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.2 lidhur me par.1, e lidhur me nenin 31 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, dhe 69 të KPRK-së dhe nenet 242, 364 dhe 365 të KPPRK-së të akuzuarit i gjykon:

Të akuzuarin U.T.,

DËNIM ME KUSHT

Duke i vërtetuar dënimin me burgim, në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti , nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen vepër te re penale.

Të akuzuarin T. T.,

DËNIM ME KUSHT

Duke i vërtetuar dënimin me burgim, në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti , nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen vepër te re penale.

Të dëmtuarën KRU Radoniqi me seli në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohen të akuzuari që ti paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale në bazë të llogarisë se gjykatës, në emër te paushallit gjyqësor të paguaj secili shumën prej 20,00 euro dhe në emër të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit secili shumën prej 20,00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP/II.nr.257-1/23, të datës 13.03.2023, ndaj të akuzuarve, U.T., dhe T. T., që të dy nga fshati Piranë, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje, Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.2 lidhur me par.1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas pranimit të shkresave të lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues me datën 17.01.2024 ka caktuar seancën gjyqësore, në të cilën të akuzuarit U.T., dhe T. T., pas udhëzimeve të dhëna nga gjyqtari i vetëm gjykues, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit ka theksuar se nuk e kundershton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 242 lidhur me 241 të KPPRK-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjykata konstatoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuzat, në materialet e prezantuar nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuzat nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe konform nenit 241 e 242 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtim fillestar nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës si, procesverbalin mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit Xhafer Gashi të hartuar në Stacionin Policor në Prizren-Veri, me datë 12.01.2023, procesverbalin mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit U.T., i hartuar në Stacionin Policor në Prizren-Veri me datë 27.01.2023, procesverbalin mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit T. T., i hartuar në Stacionin Policor në Prizren-Veri me datë 08.02.2023, raporti mbi dokumentimin e vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës, dt.12.01.2023, njoftimin lidhur me dëmin e shkaktuar, përpiluar nga KRU “Radoniqi – Dukagjini” me seli në Gjakovë, dt.12.01.2023, procesverbal për vlerësimin e dëmeve, përpiluar nga KRU “Radoniqi – Dukagjini” me seli në Gjakovë, dt.16.01.2023, raporti i paramasës dhe paralogarisë me nr.prot.44, datës 17.01.2023, foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera në lëndë, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj kjo gjykatë duke u bazuar në këto që u thanë më lart vërtetoi gjendjen faktike se në veprimet e të akuzuarve, plotësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të kryer në bashkëkryerje, Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.2 lidhur me par.1, lidhur me nenin 31, prandaj dhe ua shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të akuzuarin U.T., prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, keardhjen e shfaqur, rrethanat personale se është pensionist, i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur pjesmarrjen e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, për të akuzuarin T. T., prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, keardhjen e shfaqur, rrethanat personale se është i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, baba i tre fëmijëve, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur pjesmarrjen e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, në dëm të shoqërisë. Andaj nga këto të theksuara gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla, të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me peshën e veprës penale të kryer, me rrethanat personale dhe shkallen e përgjegjësisë të cilat i posedojnë secili nga të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, e mori në kuptim të nenit 449 dhe 451 të KPPK-së.

Vendimi mbi pagesën e taksës në emër të Programit për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin për kërkesat pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 457 të KPPRK-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
P.nr.246/2023, i datës 17.02.2024

G j y q t a r i
Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë(30) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.